

**WHEN ARTICLES ABOUT THE FIRST ALBANIAN SCHOOL  
STARTED TO BE PUBLISHED IN THE NEWSPAPER “FLAKA E  
VËLLAZËRIMIT”  
KUR FILLUAN TË BOTOHEN ARTIKUJT PËR MËSONJËTOREN E  
PARË SHQIPE NË GAZETËN “FLAKA E VËLLAZËRIMIT”**

**Berton SULEJMANI<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

<sup>\*</sup> *Corresponding author e-mail: berton.sulejmani@unite.edu.mk*

---

**Abstract**

On the occasion of the 135th anniversary of the First Albanian School in Korçë, I will give some information about the articles that were published on this important date for our nation, in the newspaper “Flaka e vellazërimit” and later only “Flaka” that was published in Skopje. We have extended our research in two time periods of the newspaper (1950 - 1990; 1991 - 2005). For the record, its first issue was published in April 1945. Unfortunately, this newspaper is no longer being published. Otherwise, this newspaper for the Albanians of Eastern region (now North Macedonia) has played an extremely large role for the emancipation and for the cultural development of the Albanians.

**Key words:** *albanian language, albanian school, albanian newspaper.*

**Përmbledhje**

Me rastin e 135-vjetorit të Mësonjëtores së Parë Shqipe në Korçë do të jap një të dhënë rreth shkrimeve që janë botuar enkas për këtë datë të rëndësishme të kombit tonë në gazetën “Flaka e vëllazërimit” e më vonë vetëm “Flaka” që është botuar në Shkup. Hulumtimin tonë e kemi shtrirë në dy periudha kohore të gazetës në fjalë (1950 - 1990; 1991 - 2005). Sa për njoftim, numri i parë i saj doli në prill të vitit 1945. Për fat të keq, kjo gazetë më nuk botohet. Përndryshe, kjo gazetë për shqiptarët e Trevave Lindore (sot Maqedonia e Veriut) ka luajtur një rol jashtëzakonisht të madh për emancipimin dhe për ngritjen kulturore të shqiptarëve.

**Fjalët kyçe:** *gjuha shqipe, shkolla shqipe, gazetat shqiptare.*

---

## Dy-tri fjalë për gazetën „Flaka e vëllazërimit”

Sivjet shënojmë 135-vjetorin e Mësonjëtores së Parë Shqipe që u hap në Korçë. Po këtë vit, shqiptarët në Maqedoni shënojnë 77-vjetorin e daljes në dritë të numrit të parë të gazetës „Flaka e vëllazërimit” (më poshtë vetëm „Fv”) që doli në Shkup. Ç’është e vërteta, historia e gazetarisë shqiptare në Maqedoni, s’fillon me këtë gazetë. Por rrënjët e saj i ka më të thella<sup>1</sup> se 77 vjetët e „Fv”-së. Para saj janë të njohura gazetat „*Bashkimi i Kombit*” që doli në Manastir dhe „*Shkupi*” që doli në Shkup. Numri i parë i saj (pra i „Flakës ...”) doli në pranverën e vitit 1945<sup>2</sup> në Shkup. Fillimet e para ishin të vështira sepse kjo gazetë filloi punën e saj me një ekip të vogël redaktues (4-5 njerëz) kryesisht amatorë në fushën e gazetarisë. Por, me kalimin e viteve ajo u zhvillua tepër dhe për shqiptarët e këtyre trevave ka luajtur një rol kolosal për ngritje e vetëdijes intelektuale e kombëtare.

Nga viti 1945 – 1958 dilte një numër në dy javë, nga viti 1958 – 1971 dilte një numër në javë, nga viti 1971 – 1994 tri herë në javë dhe nga viti 1994<sup>3</sup> u shndërrua në gazetë e përditshme informative. Nga gjiri i kësaj gazete dolën edhe revistat për fëmijë, si: „*Gëzimi*” (1950) dhe „*Fatosi*” (1955). Në vitin 1962 fillon të botohet revista për shkencë, art, letërsi dhe kulturë „*Jehona*”.

Brenda faqeve të gazetës që ofronte informacione të shkruara, komente, analiza kritike, kronika të ngjarjeve dhe burime të tjera, aq sa i lejohej asaj dhe ashtu siç arrinte të tejkalojë censurën e kohës që, megjithatë ishin të efektshëm për ngritjen e kulturës dhe arsimit të gjeneratave dhe intelektualëve të kohës që numëroheshin me gishta. Por jo vetëm kaq. Për më shumë „Fv” në numrat e radhës luante edhe rolin e teksteve të munguara shkollorë; ndihmonte në mënyrë të veçantë mësuesit e kohës të cilët ishin të pakualifikuar ose gjysmë të kualifikuar. D.m.th. se brenda gazetës janë përfshirë edhe rubrikat që kanë të bëjnë me kulturën, arsimin, zbavitjen, humorin etj.

Sa për ta ilustruar rolin e madh që pati kjo gazetë për shqiptarët e pas Luftës së Dytë Botërore të Maqedonisë po e nis me *artikullin që lidhet me shkollimin e vajzave shqiptare të këtyre trevave shqiptare*. Vlen të përmendet artikulli me titull “*Dy vajzat e para të Nerashtes*” i botuar në vitin 1970.<sup>4</sup> Nëpërmjet këtij artikulli i bëhet me dije opinionit se edhe prindërit e tjerë duhet të veprojnë si prindërit i këtyre dy vajzave (Tafijes dhe Fikrije Xheladinit). Janë dy vajzat e këtij fshati që e hapën rrugën kaq të vështirë për shkollimin e vajzave të kësaj ane që me shembullin e tyre kontribuuan që nesër ta ndjekin rrugën e tyre edhe më shumë e më shumë vajza të tjera që dëshirojnë t’i vazhdojnë mësimet në shkollat e mesme e të larta. Artikuj të tillë do të gjejmë shumë në këtë gazetë, por këtë rast s’është objekt yni kryesor.

Një nga rubrikat që zinte vend kryesor ishte ajo me titull: „*Ç’thotë profesori i shqipes*”. Këtë rubrikë e mbulonte Rexhep Zilatku, ndërsa profesori që jepte përgjigje ishte prof. Remzi Nesimi. Po e ilustrojmë këtë rubrikë me disa nga pyetjet më të shpeshta të kohës që i drejtoheshin profesorit të gjuhës shqipe:

---

<sup>1</sup> Për më tepër shih punimet e botuara në revistën SCUPI që e boton Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, vëllimi 10, 2015. Aty ke këto punime: **Skënder Asani** *Fjalë përshëndetëse*; **Naser Selmani** *Fjalë përshëndetëse*; **Sevdail Demiri** *70-vjetori i botimit të numrit të parë të gazetës „Flaka...”*; **Ismet Osmani** *Publicisti, pedagogu dhe studiuesi Petro Janura (1911 – 1983)*; **Fejzi Bojku** *Fletë nga ditari*; **Tahir Zajazi** „*Flaka...*” e vështruar nga këndi pedagogjik dhe kulturologjik; **Xheladin Murati** *Kontributi i „Flakës” në afirmimin e mendimit pedagogjik*; **Berton Sulejmai** *Kujdesi ndaj para dhe pas 1972-shës në gazetën „Flaka e vëllazërimit”*; **Zeqirja Rexhepi** *Gazeta „Flaka” medium në të cilin besoj*; **Daut Dauti** *Një betejë madhore e fituar në monizëm dhe dështimi në pluralizëm*; **Mixhait Pollozhani** *Nga notesi i një korrespondenti-kronikë strugane dhe gjurmë kohësh*; **Pamje nga tribuna dhe ekspozita**.

<sup>2</sup> Numri i parë i gazetës „*Flaka e vllaznimit*” doli nga shtypi më 4 prill 1945 në Shkup si organ i Frontit Nacionalçlirimtar për Shqiptarët e Maqedonisë.

<sup>3</sup> Dhjetë vjet më vonë shuhet krejt.

<sup>4</sup> Gazeta „*Flaka e vëllazërimit*” (më poshtë vetëm „Fv”), viti XXIV, nr. 970, 15 kallnor 1970, f. 6 (autor i shkrimit Menduh Ajdini).



**1. A duhet ta flas atë gjuhën e pleqve tanë të cilën e di ashtu siç është apo gegërishten letrare?**<sup>5</sup> Jo. Për këtë dilemë nuk kam, - shprehej ai që e parashtronte pyetjen. Por, ç'të bëj që nuk e di? Profesor Remzi Nesimi kështu i përgjigjej: *Në pyetjen tuaj se a duhet të përpiqemi që ta flasim ose, më mirë të themi, që ta vëmë në jetë gjuhën e unifikuar, lirisht mund të përgjigjemi se nuk duhet të presim asnjë moment. E këtë në radhë të parë duhet ta bëjnë shkollat, sepse redaksitë, siç e dimë, qysh me kohë – pas Konsultës gjuhësore në Prishtinë (e „Flaka” edhe më parë) – e përdorin këtë gjuhë.*

**2. Kujt i takon kjo detyrë së pari?** (kupto: kusht duhet ta flasë gjuhën e unifikuar së pari?) – Prof. R. Nesimi: *Përveç shkollave dhe redaksive janë të obliguara të gjitha institucionet kulturore dhe administrative, në radhë të parë teatri, organet administrative etj.*<sup>6</sup> *Po për përpjekjet individuale? Pse, siç dihet, ja po mbushen dy vjet qysh se u pajtuam që ta unifikojmë gjuhën tonë por, megjithatë, ne, si në jetën e përditshme, ashtu edhe në disa raste të karakterit zyrtar dhe publik, vazhdojmë me të mëparshmen... Prof. R. Nesimi: Kjo është çështje e komplikuar. Mendojmë se do të kalojë edhe një kohë e gjatë derisa intelektualët tanë ta flasin rrjedhshëm këtë gjuhë. Këtu hasin vështirësi edhe punëtorët profesionalë – sidomos kur është fjala e të folurit. Ndoshta në shkrimet tona kemi bërë hapa përpara, por në të folur, siç thamë, do përpjeke brenda një kohe relativisht të gjatë. Tjetër gjë është ta shkruash, tjetër ta flasësh. Për këtë të gjithë kemi qenë të vetëdijshëm kur vendosëm ta unifikojmë gjuhën.*<sup>7</sup>

**3. Shok profesor, (do të shkruhej në atë kohë), cilat elemente paraqesin vështirësi më të mëdha për përvetësimin e gjuhës së unifikuar?** Prof. R. Nesimi: *Të flitet për vështirësitë, do të thotë të përmenden shkurtimisht ato pak ndryshime në mes të toskërishtes e gegërishtes e këto kryesisht janë 3-4 elemente në fonetikë, si p.sh. kthimi i **a**-së hundore në **ë** para tingujve hundorë **n** dhe **m** e kjo bëhet për t' u zhdukur i ashtuquajtur nazalitet. Kështu kemi: hana – hëna, kamba – këmba etj. Element tjetër është edhe kthimi i diftongut të gegërishtes **ue** në **ua**, p.sh. grue – grua, mue – mua etj; por jo edhe te mbiemrat foljorë që formohen me prapashtesën **-shëm, -shme**, si: i lexueshëm e lexueshme, i durueshëm e durueshme si edhe ca emra foljorë që mbarojnë me **ues**, si: mësues, mësuese; lundrues, kallëzues etj. por me këtë rast duhet theksuar se çështja e këtyre emrave akoma është e diskutueshme, veç tjerash, thekson prof. Nesimi.*<sup>8</sup>

<sup>5</sup> Gazeta „Flaka e vëllazërimit” (kulturë, arsim, shkencë, zbavitje, humor..., nr 972/4 e enjte, 29 kallnor (janar) 1970, f. 2.

<sup>6</sup> Gazeta „Flaka e vëllazërimit” (kulturë, arsim, shkencë, zbavitje, humor..., nr 973/5 e enjte, 5 fror (shkurt) 1970, f. 2.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Gazeta „Flaka e vëllazërimit” (kulturë, arsim, shkencë, zbavitje, humor..., nr 975/6 e enjte, 5 mars 1970, f. 2.

4. **Pse u morr toskërishtja si bazë për gjuhën e përbashkët?**<sup>9</sup> *Fakti që quhet gjuhë e unifikuar apo e përbashkët do të thotë se për formimin e saj janë marrë elemente nga të dy kryedialektet e shqipes. Megjithatë në pikëpamje të fonetikës gjuha e unifikuar më tepër është bazuar në elementet fonetike toske dhe atë me të drejtë. Në radhë të parë duhet përmendur se dialekti i jugut që me kohë ka qenë më i përpunuar. Përveç kësaj në këtë dialekt kemi një tingëllim më melodik gjë që ligjërimin e bën më muzikor, prandaj shqipja radhitet ndër gjuhët më melodike të botës. Që toskërishtja është më melodike flet edhe denazalizimi i tingujve hundorë të gegërishtes, - shkruan prof Nesimi.<sup>10</sup>*

5. **Kryedialektet e shqipes kanë edhe ndryshime në fondin e fjalëve, si p.sh. fshat – katund, qumësht – tambël etj. Ç’mendoni për fatin e këtyre fjalëve në gjuhën e përbashkët?** Prof. R. Nesimi: *Është e vërtetë se dialektet, përveç elementeve të tjera, ndryshojnë në mes tyre edhe në pikëpamje të fjalorit. Për fat të mirë, ndryshimet e këtilla në mes dy kryedialekteve të shqipes janë minimale, gjë që edhe e lehtësojnë procesin e unifikimit të kësaj gjuhe. Por disa fjalë si: tambël, katund, katundar mendojmë se do të mbeten si dialektizma, - shkruan profesori në fjalë i gjuhës shqipe.*

Në kudër të kësaj pjese të gazetës në fjalë s’mungonin edhe shkrimet për fëmijë. Kjo rubrikë quhej „*Për fëmijët tanë*”. Këtu kishin mundësi që fëmijët më të talentuar dhe të nxitur nga mësuesit e gjuhës të shkruajnë poezi e krijime tjera letrare e që pastaj të botoheshin në kuadër të gazetës.

Por, veç krijuesve të vegjël, aty-këty do të gjejmë edhe shkrime të mësuesve, gazetarëve, profesorëve etj. Gjatë hulumtimit kam gjetur disa shkrime të profesor Petro Janurës.<sup>11</sup> Po e veçojmë shkrimin me titull *Kur filloi të shkruhet shqipja*.<sup>12</sup> Në një mënyrë shumë të thjeshtë dhe të kapshme për fëmijët, dr. Petro Janura do të shkruante: *për dy shekuj shqipja nuk u shkrua rregullisht e lirisht, pse filloi sundimi otoman. Lind pyetja: çfarë librash do të jenë shkruar para vitit 1332, pasi te ne, deri tani, nuk ka mbërritur asnjë libër i kësaj kohe, por duke e pasur parasysh jetën e popujve që bënin në atë kohë, besohet se duhet të jenë botuar libreza ose formularë të ndryshme tregtie e fetare. Mungesa e librave dhe formularëve bën studimi i gjuhës sonë të fillojë prej vitit 1555, pra 223 vjet më vonë. Sido që të jetë, shqipja ka filluar të shkruhet, të paktën, para 630 vjetësh. Megjithëkëtë, libra të kësaj kohe të lashtë nuk ka. Kjo, sepse sundimi otoman shkatërroi çdo gjuhë kulturore dhe qytetërimi në gjuhën shqipe dhe të shqiptarëve.*<sup>13</sup>

**Artikujt për 7 Marsin ose Ditën e Mësuesit.** Gjatë vëzhgimit tonë të numrave të gazetës në fjalë mund të përfundojmë se gjatë periudhës 46-vjeçare (1945 – 1991) nuk kemi gjetur asnjë shkrim kushtuar kësaj feste mbarëkombëtare (pra, kjo gjë nuk është e rastit, por qëllimisht nuk janë lejuar ose angazhuar njerëz që të shkruajnë për këtë datë të rëndësishme të kombit tonë). Për shkak të vëllimit shumë të madh të gazetës në fjalë, hulumtimin tonë e kemi përqendruar kryesisht te numrat e muajve shkurt e mars, gjithnjë, duke e pasur parasysh edhe datën e kësaj feste, 7 marsin. Nga ana tjetër, s’mungojnë shkrimet për *Festën Ndërkombëtare të Gruas* apo 8 *Marsin*. Shkrimet për festën e gruas i gjejmë edhe në pjesën „*Për fëmijët tanë*”. Aty s’mungojnë krijimet e ndryshme letrare, si poezi, tregime etj., që u kushtohen nënave.

<sup>9</sup> Gazeta „*Flaka e vëllazërimit*” (kulturë, arsim, shkencë, zbavitje, humor..., nr 977/8 e enjte, 19 fror (shkurt) 1970, f. 2.

<sup>10</sup> Po aty.

<sup>11</sup> Themelues i Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare të Fakultetit Filologjik të Universitetit Shën Cirili e Metodi në Shkup.

<sup>12</sup> Gazeta „*Flaka e vëllazërimit*” (kulturë, arsim, shkencë, zbavitje, humor..., nr 973/5 e enjte, 5 fror (shkurt) 1970, f. 11.

<sup>13</sup> Po aty.

Artikujt që shkruhen enkas për **Mësonjëtorën e Parë të Shqipërisë** ose **7 Marsin**, i kemi gjetur në numrat e „*Flakës së vëllazërimit*” që nga pluralizmi dhe mëvetësia e Republikës së Maqedonisë e deri kur u botua kjo gazetë (1991 – 2005). Në prag të çdo përvjetori të kësaj feste mbarëkombëtare, s’do të mungojnë edhe shkrimet për personalitetet e njohura, ilumistët, mësuesit e patriotët e këtyre trevave shqiptare, por edhe më gjerë që kontribuuan për shkollat dhe gjuhën shqipe. S’mungojnë shkrimet edhe për figurat e ndritura të Rilindjes Kombëtare. Për ta dëshmuar këtë që po e themi, veç disa fotografive, do t’i shënojmë titujt e disa artikujve, si:

1. *106-vjetori i shkollës së parë shqipe*, dr. Mahmud Hysa, 5 mars 1993, f. 15;
2. *Mësonjëtorja e Korçës – dritare e historisë sonë kombëtare*, A. Sinani, 7 mars 1993, f. 5;
3. *Said Najdeni pishtar i lëvizjes gjithëkombëtare*, Dr. Mahmud Hysa, 17 mars 1993, f. 19;
4. *Mësonjëtorja e parë shqipe – fundament i arsimit kombëtar*, Dr. Xheladin Murati, 21 mars 1993, f. 15;
5. *Për të bukurën gjuhë e shkollë shqipe (në 105-vjetorin e shkollës së parë në Korçë)*, Vebi Furxhi, 12 mars 1992, f. 15.
6. *Pikëpamjet për kategoritë themelore pedagogjike (Naim Frashëri për edukatën dhe arsimin gjatë Rilindjes Kombëtare)*, dr. Xheladin Murati, 27 shkurt 1992, f. 12;
7. *Dita e arsimitarit – pa arsimtarë shqiptarë (për arsimtarët shqiptar të Kosovës gjatë pushtimit të egër serb – dëbimi i arsimtarëve nga shkollat)*;
8. *Shumë sakrificë për një qëllim (shkollat dhe arsimit shqiptar prej vitit 1878 deri më 1918)*, G. Islami, 6 mars 1996, f. 11;
9. *Shkolla e Korçës – çerdhe e diturisë dhe e ngritjes së vetëdijes kombëtare (në vigjilje të 7 Marsit – Ditës së Mësuesit)* I. Jusufi, 6 mars 1996, f. 3;
10. *7 Marsi – fitore gjithëkombëtare*, dr. Avzi Mustafa, 7 mars 1996, f. 12;
11. *Shkolla shqiptare qëndron mbi eshtrat e patriotëve tanë*, Avzi Mustafa, 6 mars 1995, f. 8;
12. *Vatër e edukimit dhe vetëdijes kombëtare (në 107-vjetorin e shkollës shqipe në Korçë)*, Mr. Abdylaziz V. 9 mars 1994, f. 6;
13. *Mësonjëtorja e Korçës – shkollë e parë shqipe me fizionomi kombëtare laike*, Dr. Nexhat Abazi, 7 mars 1995, f. 7.



Për nder të kësaj dite, s'kanë munguar edhe shkrimet për mësuesit dhe mësueset e njohura të arsimit shqip. Por edhe shkrimet për teatrin e Korçës, si:

1. **Parashqevi Qiriazi (mësueset e para shqiptare)**, 7 mars 1993, f. 5;
2. **Profesioni si dashuri**, (skicë për portret), I. Islami, 8 mars 1992, f. 13;
3. **101 vjet të Teatrit të Korçës**, Naxhi Ndoci;
4. **Abdi Begu – Haxhiu – pishtar i arsimit**, Ilmi Egriu, 4 mars 1996, f. 10;
5. **Mision që kërkon dashuri dhe përkushtim të njëmendtë**, (Shtatë Marsi: me pishtarët e arsimit), I Jusufi, 7 mars 1996, f. 11;
6. **Në ballë të eliminimit të analfabetizimit**, (Shtatë Marsi: me pishtarët e arsimit), I Jusufi, 7 mars 1996, f. 11;
7. **Sevasti Dako (Qirjazi)-intelektuale e shquar**, dr. Iljaz Gogaj, 8 mars 1996, f. 12.
- 8.



Në faqet gazetës kemi gjetur edhe kronikë ngjarjesh që lidhen me manifestimet e ndryshme që janë organizuar enkas për Ditën e Mësuesit. Te faqet që përfshiheshin kronikat e ngjarjeve do të shohim edhe disa shkrime që lidhen me këtë festë mbarëkombëtare, por që i kishte organizuar Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë (LASH) si:

1. *U shënuan dita e mësuesit dhe dita e shkollës*, (në shkollën fillore „Përparimi”-Çegran, A. S.;
2. *Përkujtohet Said Najdeni – Hoxhë Voka*, N. S. 5 mars 1993, f. 15;
3. *Faqe e ndritur e historisë sonë kombëtare (nga shënimi i 7 Marsit – Ditës së Mësuesit në shkollën „Liria” të Shkupit)*, 11 mars 1992, f. 6;
4. *Manifestime nëpër shkolla (shënimi i Ditës së Mësuesit në Gostivar)*, 6 mars 1996, f. 6;
5. *Solemnisht u shënuan 7 Marsi (shënimi i Ditës së Mësuesit në Dollogozhdë, Strugë)*, 6 mars 1996, f. 6;
6. *Një varg manifestimesh për 7 Marsin (shënimi i Ditës së Mësuesit në Dibër)*, 6 mars 1996, f. 6;
7. *Një datë – dy manifestime qendrore (!) (manifestime qendrore për shënimin e Ditës së Mësuesit në Shkup e Tetovë)*, 9 mars 1996, f. 2;
8. *Manifestim për Ditën e Mësuesit (Dibër)*; 5 mars 1995, f. 5;
9. *Mirënjohje veteranëve dhe arsimitarëve të dalluar (dita e arsimit shqip u shënuan edhe në Kumanovë)* 5 mars 1995, f. 5;
10. *Skademi solemne për Ditën e Mësuesit (Teatri Shqiptar, Shkup)* 5 mars 1995, f. 5;
11. *Vatër për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare* (nga academia solemne kushtuar 7 Marsit-Ditës së Mësuesit, Shkup, organizuar nga LASH-i, I. J. 9 mars 1994, f. 3;
12. *Solemnisht u shënuan Dita e Mësuesit* (në organizim të LASH-it, dega Gostivar), I. J. 9 mars 1994, f. 3;
13. *U shënuan Dita e Mësuesit* (urimet e kryetarit Ibrahim Rugova për Ditën e Mësuesit, Prishtinë), 9 mars 1995, f. 4;
14. *Arsimi – rrugë drejt progresit* (nga academia solemne e mbajtur në teatrin e Kombësive në Shkup), 9 mars 1995, f. 5;
15. *Dita e Mësuesit u shënuan solemnisht* (Strugë), 9 mars 1995, f. 5.



**Festimi i Ditës së Mësuesit në Shqipërinë e pas Luftës së Dytë Botërore** (më poshtë LDB). Duke u mbështetur në të dhënat e mësipërme, vijmë në përfundimin se në Maqedoninë e pas LDB-së festimi i kësaj feste mbarëkombëtare ka filluar pas vitit 1991. Ndërsa në Shqipërinë e pas LDB-së, duke u mbështetur në të dhënat e Fjalorit Enciklopedik Shqiptar,<sup>14</sup> Dita e Mësuesit festohet që nga viti 1960, si përkujtim i Mësonjëtores së Parë Shqipe të Korçës që u hap më 7 mars 1887.

<sup>14</sup> Fjalori Enciklopedik Shqiptar, ASHSH, f. 490, Tiranë, 2008.

## **Përfundim**

Dalja në dritë e një organi si ky (prill, 1945), në mjeshtet gjuhësore të Shkupit, Tetovës, Kumanovës, Gostivarit, Kërçovës, Dibrës, Strugës, Ohrit, Manastirit, d.m.th. në këtë treva shqiptare të ish-Jugosllavisë (sot Maqedoni e Veriut) kishte një rëndësi të madhe, përveç tjerash, edhe për përhapjen e ngulitjen e normës së gjuhës standarde shqipe. Gjeografia gjuhësore kapte jo vetëm qytetet e Maqedonisë, po edhe të Kosovës e më gjerë. Që do të thotë se përfshinte të gjitha veçoritë e të folmeve, por me punën e kujdesshme të redaktorëve njësoheshin mirë në faqet e gazetës. Nuk mungonin edhe shkrimet e autorëve joshqiptarë (serb, kroatë, maqedonas etj.) që i përkthenin e i redaktonin mirë. Vitet e tetëdhjeta, pas demonstratave studentore dhe mbarëkombëtare në Kosovë, veç tjerash, rezultoi me ndalimin e përdorimit të toponimeve shqipe, si në media ashtu edhe në librat shkollorë. Në këtë drejtim, nga tri mediet e asaj kohe „Flakës së vëllazërimit”, Radio Shkupit dhe Televizionit të Shkupit, vetëm „Flaka...” arriti ta fitojë betejën kundër imponimit të dhunshëm të toponimeve sllave (p.sh. të shkruhej Skopje për Shkup).

Në këtë punim përmendëm vetëm dy çështje të rëndësishme të gazetës, por ndihmesa nëpërmjet shkrimeve të saj ka qenë e shumanshme. Sa i përket thelbit të temës, mund të përfundojmë se artikujt për këtë festë mbarëkombëtare do t'i gjejmë vetëm pas vitit 1991 e deri në fund të daljes në dritë të saj. Pra gjatë periudhës 1945 – 1991 nuk ka asnjë shkrim që lidhet me 7 Marsin ose Ditën e Mësuesit.

## **Referencat**

- [1]. ASHSH, *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Tiranë, 2008.
- [2]. Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup (ITSHKSH) *SCUPI*, nr. 10, Shkup, 2015.